



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.2

Dhjetor 2024

RRITJA E BASHKËPUNIMIT RAJONAL NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE DHE SFIDAT PËRKATËSE

Idriz Haxhiaj* Besjana Lazja Ildir Robi*****

**Albanian University, Tirana, Albania*

***Expert on issues of the International Security and of the Public Safety, Tirana, Albania*

**** Expert on issues of the Organised Crime and Illicit Financing, Tirana, Albania*

Përmbledhje

Fenomeni i korrupsionit dhe pastrimit të parave është një ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballen shoqëritë moderne në ditët e sotme. Ky fenomen përbën një kërcënim serioz për sigurinë dhe stabilitetin e kombeve por edhe më gjerë. Ai minon demokracinë, çënon sundimin e ligjit dhe pengon zhvillimin ekonomik e social të vendeve. Strukturat kriminale, në përpjekje për të forcuar pozitat e kanë shtrirë veprimtarinë e tyre në forma të shumëfishta. Në këtë kontekst, kërcënimet që shfaqen në kontekstin e gjerë shoqëror adresojnë nevojën për një bashkëpunim serioz dhe të strukturuar rajonal por edhe ndërkombëtar. Ky bashkëpunim lypset të zhvillohet në të gjitha nivelet, operacionale e politikë-bërëse si dhe në të gjitha planet, teknologjike e njerëzore. Korrupsioni dhe qarkullimi i financave të paligjshme janë një veprimtari kriminale që nuk njohin kufij shtetërorë dhe si të tilla kërkojnë veprim dhe kundërpërgjigje të përbashkët ndërkombëtare. Me qëllim trajtimin dhe adresimin e këtij fenomeni global është ndërmarrë realizimi i këtij punimi kërkimor. Analiza e paraqitur në këtë punim fokusohet tek natyra transnacionale e këtyre dukurive kriminale, format e sofistikuara të krimit, nevoja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, iniciativat kryesore strategjike dhe ligjore të ndërmarra në këtë drejtim dhe qasjen rajonale që BE e partner të tjerë aplikojnë në vendet e rajonit tonë. Kuadri strategjik i miratuar për këtë qëllim dhe përpjekjet e vazhdueshme dhe të strukturuar për linjëzimin e tij me BE do të shërbejë si një platformë e përshtatshme e cila do të mundësojë veprime dhe iniciativa të tjera institucionale rajonale për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe financimeve të paligjshme.

Metodologjia e përdorur për realizimin e punimit është një qasje krahasuese e burimeve dhe të dhënave zyrtare, raporteve të publikuara nga grupet e interesit dhe studimeve të realizuara në këtë fushë, duke përfshirë analiza rrisku, njëhësim të kuadrit strategjik, mekanizma bashkëpunimi, integrim sistemesh e shkëmbim informacioni dhe investime të përbashkëta.

Gjetjet e punimit kërkimor tregojnë se mbështetja institucionale është mjet i domosdoshëm në luftën kundër krimit transnacional. Ndërtimi i një sistemi me rregulla, në të cilin institucionet janë funksionale dhe shërbimet janë efikase është një nevojë e menjëhershme në luftimin e këtyre fenomeneve kriminale. Nga ana tjetër luftimi i këtyre formave kriminale përbën një prioritet kyc për

integrimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian. Nga të dhënat e grumbulluara dhe analiza e realizuar, punimi paraqet rekomandimet e nevojshme për frenimin e fenomenit të korrupsionit dhe pastrimit të parave.

Fjalë kyçe: *bashkëpunim rajonal, anti-korrupsion, lufta kundër pastrimit të parave, udhërrëfyesi anti-korrupsion, procesi integruar.*

INCREASING REGIONAL COOPERATION IN THE FIGHT AGAINST CORRUPTION AND MONEY LAUNDERING AND RELATED CHALLENGES

Abstract

Corruption and money laundering are global issues that pose major challenges to modern societies. This phenomenon poses a serious threat to national and international security and stability. It weakens democracy, breaches the rule of law, and slows down the country's economic and social progress. In order to improve their positions, criminal organizations have expanded their activities into a variety of forms. In this context, the threats that appear in the wider social context address the need for serious and structured regional and international cooperation. This cooperation needs to be developed at all levels, operational and policy making as well as at all levels, technological and human.

The purpose of conducting this research paper was the treatment of this phenomenon. The analysis focuses on the transnational nature of these criminal phenomena, sophisticated forms of crime, the need for international and regional cooperation, the main strategic and legal initiatives taken in this direction, and the regional approach used by the EU and other partners in our region's countries. The strategic framework developed for this goal, as well as ongoing and systematic efforts to align with the EU, will serve as an appropriate basis for further regional institutional measures and initiatives aimed at strengthening the fight against corruption and illegal money flows.

The methodology used to accomplish the research paper is a comparative approach based on official sources and data, reports published by interest groups, and studies conducted in this field, including risk analysis, strategic framework calculation, cooperation mechanisms, system integration etc.

Based on the data collected, the paper makes the required suggestions for fighting corruption and money laundering.

Keywords: *regional cooperation, anti-corruption, fight against money laundering, anti-corruption roadmap, integration process.*

Hyrje

Në ditët e sotme fenomeni i krimit të organizuar mbetet kompleks dhe përbën një ndër kërcënimet kryesore të aktorëve qeveritare dhe atyre ndërkombëtare që kapërcejnë kufijtë shtetërore. Natyra multidimensionale e këtij fenomeni, evoluimi dhe aftësia e tij për t'u përshtatur ndryshimeve globale e zhvillimeve teknologjike e bën kundërvënien e tij një sfidë globale e cila ka nevojë për adresim të kujdesshëm dhe bashkëpunim ndërkombëtar intensiv. Asnjë shtet i vetëm nuk mund të triumfojë kundër krimit të organizuar për të cilin nevojitet një përgjigje e koordinuar mes institucioneve relevante dhe aktorëve joqeveritarë dhe ndërshtetërore në rang rajonal e global.

Format e krimit të organizuar paraqesin një kërcënim serioz pasi kanë dëshmuar aftësinë e tyre për t'u infiltruar në strukturat politike, ekonomike dhe ato shoqërore, shpeshherë përmes korrupsionit dhe

pastrimit të parave. Një dukuri e tillë jo vetëm që cënon të drejtat themelore të njeriut, por gjithashtu thellon pabarazinë shoqërore dhe ekonomike.¹ Në nivel shtetëror, krimi i organizuar cënon stabilitetin politik, nxit paqëndrueshmërinë sociale dhe minon progresin ekonomik duke u bërë faktor kyç për mosrealizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjikë të caktuar.

Të vetëdijshëm për natyrën multidimensionale të krimit të organizuar si dhe shumëllojshmërinë e disiplinave që trajtojnë fenomenin nga këndvështrime të ndryshme, pjesa më e madhe e studimeve të kryera e kanë pranuar vështirësinë për të dhënë një përkufizim të qartë dhe të njohshëm të fenomenit. Megjithatë duket se është arritur një konsensus i caktuar mbi përkufizimin e krimit të organizuar të dhënë nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (UNTOC). Konkretisht në nenin 2 të saj² parashtrohet se:

“Grup i organizuar kriminal” do të thotë një grup i strukturuar prej tre ose më shumë personave, që ekzistojnë për një periudhë kohore dhe që veprojnë në bashkëpunim me qëllimin e kryerjes së një ose më shumë krimeve ose veprave penale të rënda të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë, me qëllim që të përfitohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose ndonjë përfitim tjetër material.

Gjithashtu, në këtë Konventë përcaktohet kriminalizimi i veprës së “pastrimit të parave”. Në nenin 6, pika 1, a dhe b, kur kryhet me dashje, vepra e pastrimit të parave³ konsiderohet *“ndryshimi ose transferimi i pronës, duke ditur se kjo pronë është produkt i veprimtarisë kriminale, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të pronës ose për të ndihmuar një individ i cili është i përfshirë në një vepër penale për t’iu shmangur pasojave juridike të veprimit të tij/saj”*.

Në nenin 8 të saj⁴, vepra penale e korrupsionit përcaktohet si: *“Premtimi, ofrimi ose dhënia një zyrtari publik, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i një avantazhi të padrejtë, për vetë zyrtarin ose për një tjetër person ose subjekt, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në ushtrimin e detyrave të tij/saj zyrtare si dhe; kërkesa ose pranimi nga një zyrtar publik, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i një avantazhi të padrejtë, për vetë zyrtarin ose një tjetër person ose subjekt, me qëllim që zyrtari të veprojë ose të përmbahet nga veprimi në ushtrimin e detyrave të tij/saj zyrtare”*.

Pavarësisht faktit se çdo shtet apo rajon është unik, qasja politike dhe strategjike ndaj korrupsionit dhe pastrimit të parave si nënfusha të krimit të organizuar rezulton të jetë e ngjashme ku përcaktohen katër parime të përgjithshme gjithëpërfshirëse të cilët janë:

1. PARANDALIMI i krimit të organizuar nga (ri) infiltrimi në komunitete, ekonomi dhe institucione politike. Ky parim kërkon të krijojë qëndrueshmëri ndaj krimit të organizuar për të ndaluar aftësinë e tij për t’u përhapur në shoqëri;
2. NDJEKJA DHE GODITJA e grupeve të organizuara kriminale dhe përfitimeve të tyre të paligjshme me qëllim përgjigjen efikase ndaj organizimeve të tilla që cënojnë shoqërinë;
3. MBROJTJA e individëve dhe viktimave të veprimtarisë së krimit të organizuar. Ky parim njeh dëmin që krimi i organizuar shkakton tek individët dhe thekson nevojën për mbështetje që ka kjo shtresë e shoqërisë.
4. NXITJA e bashkëpunimit në të gjitha nivelet, përtej kufijve kombëtarë duke nxjerrë në pah rëndësinë e unifikimit të përgjigjes së koordinuar ndaj këtij fenomeni.

Përsa i përket sfidave, në ditët e sotme, globalizimi paraqitet si një ndër faktorët kryesore që ka ndikuar në evoluimin dhe modifikimin e mënyrave të operimit dhe lulëzimit të grupeve kriminale të organizuara. Falë këtij procesi, ndërlikohet së shtuar ekonomike, komunikimeve të lehta dhe të

1 Jill Thomas 2021, Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e kthimit të pasurive.

2 <https://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>, fq. 5

3 Po aty, fq. 8

4 Po aty, fq. 18

shpejta si dhe zhvillimit të teknologjive të reja, grupet kriminale zgjeruan aktivitetin e tyre përtej kufijve kombëtare. Kapacitetet jo të duhura të shteteve për të menaxhuar dhe monitoruar siç duhet aktivitetet transnacionale, çoi në një fluks të shtuar dhe të pakontrolluar të mallrave kontrabandë, por edhe të qenieve njerëzore⁵. Kështu, mundësitë e tilla të rritura për krimin transnacional përfaqësojnë “anën e errët të globalizimit”.⁶

Për të përballuar me sukses kërcënimet e krimit të organizuar, aktorët ndërkombëtare u organizuan duke krijuar struktura me fokus luftën kundër krimit të organizuar. Kështu, me 1994, Bashkimi Evropian krijoi Zyrën e Policisë Evropiane (EUROPOL), e cila e arriti statusin e plotë operacional në vitin 1999. Krahas punës operative, Kombet e Bashkuara nisën procesin e unifikimit legjislativ kundër krimit të organizuar duke nënshkruar Kombëtare të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional, dhe më pas Konventën kundër Korrupsionit në 2005.

2. Situata aktuale në rajonin e Ballkanit

Në dekadat e fundit të shekullit të 20-të, faktorët socialë, ekonomikë dhe politikë luajtën një rol të rëndësishëm në organizimin dhe zhvillimin e grupeve kriminale në rajonin e Ballkanit. Kriza ekonomike në fillim të viteve 1980, inflacioni dhe papunësia ishin disa nga faktorët që ndikuan në rritjen e aktiviteteve kriminale si trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabandimi i të mirave materiale dhe barnave, falsifikimi i dokumenteve zyrtare dhe mashtrimet financiare.⁷

Faktorët e sipërpërmendur patën një ndikim serioz në themelimin dhe konsolidimin e tregjeve të paligjshme ku sipërmarrësit vendorë u shfaqën si ‘ofrues shërbimesh’.⁸ Kombinimi i institucioneve të dobëta dhe kërkesës përëndimore për “mallrat e paligjshëm”, faktorizuan lulëzimin e aktiviteteve të paligjshme duke e kthyer Ballkanin në tregun perfekt për sigurimin e tyre. Një tjetër faktor që ndikoi ishte pozicioni gjeografik i Ballkanit Perëndimor duke e bërë këtë rajon tepër tërheqës për lulëzimin e aktivitetit kriminal kryesisht në trafikimin e drogës, armëve dhe njerëzve. Afërsia e rajonit me Evropën Perëndimore dhe vendndodhja e tij midis prodhuesit me të madh në botë të opiumit, përkatësisht Afganistanit dhe tregut më të madh të heroinës, përkatësisht Evropa Perëndimore⁹ e bëri rajonin tepër atraktiv për grupet e organizuara kriminale.

Pas ndryshimeve të vazhdueshme në tregun e narkotikëve, dhe në veçanti uljen e konsumit të heroinës, paralelisht me rritjen e kërkesës për kokainë, UNODC shprehu shqetësimet e saj për zgjerimin e rrugëve të kokainës drejt Evropës Lindore dhe formimit të aleancave alarmante ndëroqeanike të drogës. Evropa Juglindore, në të vërtetë, është identifikuar si një ndër pikat e reja hyrëse për kokainën që vjen nga Amerika e Jugut përmes porteve të Adriatikut dhe Detit të Zi.¹⁰ Ndër të tjera, karteli Sinaloa, një nga kartelet më të rrezikshme meksikane të drogës, gjeti në Ballkanin Perëndimor pikën hyrëse që po kërkonte për të zgjeruar tregtinë e tij drejt Evropës, ndërkohë që grupet kriminale kolumbiane dhe peruane dyshohet se po tregojnë gjithashtu interesat e tyre në biznesin e ri në rajon.¹¹

Indikatorët e ulët të përdorimit të heroinës dhe sasia e reduktuar e heroinës së kapur nga Turqia dhe Bullgaria në vitin 2020 së bashku me sasitë e mëdha të konfiskuara në Evropën Perëndimore vlerësuan se kufizimet e transportit të ndodhura prej COVID-19 mund të kenë penguar trafikimin e kësaj lënde narkotike përgjatë rrugës ballkanike për në Bashkimin Evropian. Ky faktor shpjegon gjithashtu mungesën e heroinës në vitin 2020. Megjithatë këto tregues duket se i përkasin vetëm

5 Collins A. (2014). Studime Bashkëkohore të Sigurisë (Contemporary security studies). UET/ PRESS, Tiranë, fq. 451

6 P. Williams, Transnational Criminal Networks, Networks and Netwars. The Future of Terror, Crime, and Militancy, Santa Monica, CA, Rand Corporation, f.66

7 K. Krasniqi, (2016). Organized Crime in the Balkans. *European Scientific Journal*, 12(19), 204-220.

8 <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>, fq. 18

9 K. Krasniqi, (2016). Organized Crime in the Balkans. *European Scientific Journal*, 12(19), fq.208

10 Europol (2011), OCTA 2011. EU Organised Crime Threat Assessment, The Hague.

11 Nicolaj N. (2012 November 9), Mexican drug cartels penetrate southern Europe, euobserver, <https://goo.gl/KEfWj>

periudhës së pandemisë pasi të dhënat paraprahe të sasisve të konfiskuara të heroinës për vitin 2021 treguan se shifrat po kthehen në nivelet para pandemisë.¹²

Rruga ballkanike është kthyer në qendër të vëmendjes në vitet e fundit si pasojë e lëvizjes së migrantëve përgjatë këtij korridori. Tashmë ky fenomen po bëhet një biznes i vërtetë, i cili “vlen më shumë se droga” pasi bazuar në vlerësimet e fundit trafikimi i migrantëve u shdërrua në një aktivitet mjaft fitimprurës, duke gjeneruar të ardhura prej 33.7 deri në 50.6 milion euro në 2020.¹³

Në vitin 2015, rruga kryesore e ndjekur nga azilkërkuesit dhe emigrantët ishte përmes Turqisë dhe Greqisë drejt Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, për të vazhduar drejt Hungarisë dhe më pas më tej Bashkimin Evropian (BE). Pas mbylljes së këtij korridori, në mars 2016, falë marrëveshjes së nënshkruar mes Turqisë dhe BE-së, vëmendja u zhvendos drejt vendeve të tjera të rajonit, konkretisht Bosnje Hercegovinës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, si pika tranzitore. Në vitin 2017 ka pasur një rritje të dukshme të azilkërkuesve dhe emigrantëve në Bosnje Hercegovinë dhe, në një masë më të vogël, në Malin e Zi.¹⁴ dhe që nga viti 2019, ka pasur një rritje të qartë të numrit të azilkërkuesve dhe migrantëve që hyjnë në Shqipëri me synim Evropën.¹⁵

Efektet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në institucionet shtetërore mbetet një çështje shqetësuese për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Shpesh korrupsioni shërben si një faktor lehtësues thelbësor për krimin e organizuar duke ndihmuar në pandëshkueshmërinë e elementëve të krimit të organizuar si dhe duke sjellë dhe mosrealizimin e objektivave dhe prioriteteve qeveritare.

3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

3.1 Nismat Rajonale

Gjatë viteve të fundit, në rajonin e Evropës Juglindore janë identifikuar disa nisma të bashkëpunimit rjaonal, shpesh të iniciuara dhe të mbështetura nga aktorë të jashtëm.

Ndër nismat kryesore të bashkëpunimit rajonal, **Iniciativa Bashkëpunuese e Evropës Juglindore**¹⁶ (SECI) ka qenë një nga më aktivët në këtë fushë. E inicuar në vitin 1996 nga SHBA si mbështetje për zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit, objektivi kryesor i saj ishte zhvillimi i një strategjie të qëndrueshme ekonomike në rajon. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër krimit ndërkufitar ishte një pjesë thelbësore e aktiviteteve të Iniciativës dhe lidhur me këtë, në vitin 2000, u krijua Qendra Rajonale për Luftën kundër Krimit, në Bukuresht, Rumani. E vlerësuar si një ndër aktorët kryesorë në fushën e luftës kundër krimeve kufitare, qendra zhvilloi marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me EUROPOL, INTERPOL, OSBE si dhe ndikoi për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve politikëbërës mbi sfidat me të cilat përballët rajoni e forcimin e identitetit të tij.

Në vitin 2011, SECI u shndërrua në **Qendrën për Zbatimin e Ligjit të Evropës Juglindore (SELEC)**. Objektivi parësor i qendrës ishte mbështetja e koordinimit ndërmjet vendeve të Evropës Juglindore në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit. Për të lehtësuar këtë proces si për të organizuar më mirë hetimet, janë krijuar edhe gjashtë task forca, ndër të cilat mund të përmendim Task Forcën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migrimit të Paligjshëm si dhe Task Forca kundër

12 EMCCDDA, European Drug Report 2023, fq.38, https://www.emcdda.europa.eu/publications/european-drug-report/2023_en

13 UNODC, Conceptual Framework for the Statistical Measurement of Illicit Financial Flows, October 2020, fq. 8, https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/IFF/IFF_Conceptual_Framework_for_publication_15Oct.pdf

14 Global Initiative against Organized Crime, Analyzing flows of people, drugs and money in the Western Balkans, fq. 38

15 Emma Wallis, Migrants in Albania: Begging for food, hiding from violence, Info Migrants, 21 May 2020, <https://www.infomigrants.net/en/post/24801/migrants-in-albania-begging-for-food-hiding-from-violence>

16 <https://www.seci.org/>

Trafikimit të Drogës. Përgjatë viteve SELEC është vlerësuar si një mekanizëm tepër i sukseshëm dhe efektiv rajonal që ka ndikuar në përshejtimin e proceseve hetimore dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet vendeve pjesëmarrëse.

I iniciuar nga shteti i Bullgarisë, **Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC)** është një tjetër nismë rajonale e ndërmarrë me synimin për të rritur bashkëpunimin rajonal duke pasur në fokus krijimin e strabilitetit të qëndrueshëm. Krahas vendeve të rajonit, nisma ka përfshirë dhe shtete të tjera si Moldavia, Greqia dhe Turqia. Në kuadër të kësaj nisme, krerët e shteteve kanë zhvilluar takime të rregullta duke kontribuar në përmirësimin e atmosferës politike dhe në zbutjen e tensioneve mes tyre duke pasur parasysh trazirat historike të rajonit dhe heterogjeniteti e tij.

Një tjetër nismë rajonale me fokus në luftën kundër krimit është dhe **Konventa e Bashkëpunimit Policor në Evropën Juglindore (PCC SEE)**.¹⁷ Konventa u nënshkrua në vitin 2006 dhe sipas saj, palët u angazhuan për rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe forcimin e bashkëpunimit gjatë operacioneve dhe hetimeve me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar. Të inspiruar nga traktati Prum i BE-së për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të adn-së, të dhënave daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve, shtetet palë të PCC SEE, në Vjenë, në 2018, nënshkruan marrëveshjen PCC PRUM, e cila e konkretizonte këtë bashkëpunimin rajonal të ndërmarrë, në shkëmbimin e të dhënave të cituara, hap aq i nevojshëm dhe i duhur për zhvillimin e proceseve hetimore.

Organizata e Drejtorëve të Policisë së Evropës Juglindore (SEPCA)¹⁸ u formua në janar 2002, në Kroaci, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit policor rajonal në luftën kundër krimit të organizuar duke qenë rrjeti më i lartë profesional policor i përbërë nga drejtues policie nga rajoni i Evropës Juglindore. SEPCA ka në fokus të saj promovimin e zhvillimit të praktikave, përvojave dhe metodave moderne policore, përmes zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit, përmirësimit të kompetencave profesionale të punonjësve të policisë, barazisë gjinore dhe veprimit të përbashkët për parandalimin dhe shtypjen e të gjitha formave të krimit të organizuar.

3.2 Bashkimi Evropian

Pavarësisht vështirësive të shumta, Bashkimi Evropian gjithmonë ka nxitur në mënyrë aktive bashkëpunimin rajonal. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit të BE-së, ka shërbyer si hap themelor për afrimin dhe pranimin e shteteve të rajonit në BE.

Në vitin 2008, Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore, që kishte si synim forcimin e paqes, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe ekonomisë u zëvendësua nga **Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC)**. Kjo nismë u krijua si “korniza qendrore e bashkëpunimit në EJT”¹⁹ dhe kontribuoi fuqishëm në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (duke përfshirë luftën kundër krimeve të rënda dhe të organizuara, aktivitetet në fushën e migrimit, azilit dhe refugjatëve), bashkëpunimit për sigurinë dhe rritja gjithëpërfshirëse (përfshirë strategjitë kundër korrupsionit).

Me qëllim bashkëpunimin operacional dhe në kuadër të trajtimit të migracionit të parregullt dhe krimit ndërkufiar, disa nga shtetet e rajonit (Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Moldavia) kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi²⁰ me **Agjencinë Evropiane të Rojes Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX)**. Këto marrëveshje lejojnë dislokimin e oficerëve të FRONTEX në pikat

17 [PCC SEE : About us \(pccseesecretariat.si\)](http://pccseesecretariat.si)

18 <https://www.sepcaregion.eu/about-us/>

19 Greavu S. (eds.) (2016), Annual Report of the Secretary General of the Regional Cooperation Council 2015-2016, Sarajevo, RCC.

20 [Border management: EU signs Frontex Status Agreement with Albania - European Commission \(europa.eu\)](https://ec.europa.eu/eu-external-affairs-press/en/statement/2016/06/20160620_01)

kufitare për të asistuar në menaxhimin e fluksve migratore, luftimin e imigracionit të paligjshëm, trajtimin e krimit ndërkufitar si dhe për të zhvilluar operacione të përbashkëta.

3.3 Nisma globale

Instrumenti kryesor ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar transnacional mbetet Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional e miratuar në vitin 2000. Sipas parashikimeve në këtë konventë shtetet angazhohen të miratojnë një sërë masash kundër krimit të organizuar transnacional. Fakti që të gjitha vendet e rajonit e kanë ratifikuar këtë instrument, shërben si dëshmi e trajtimit me seriozitet të problemit dhe prioritizimin e tij për ta trajtuar në nivel ndërkombëtar.

Nismat, përpjekjet dhe aktorët ndërkombëtarë vijojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar në rajon. Një ndër nismat e cila është vlerësuar me së tepërmi është Programi Rajonal për Evropën Juglindore e UNODC-së osë thënë ndryshe Iniciativa e Paktit të Parisit. Në linjë me aktet e BE-së, programi synonte t'u sigurojë vendeve të rajonit ekspertizë, mjete teknike dhe shërbime për të luftuar krimin e organizuar. Gjatë zbatimit të tij, programi ka shënuar rezultate pozitive duke nisur nga përmirësimi i aftësive dhe infrastrukturës për policinë kufitare, gjë që rezultoi në një sasi të shtuar droge të kapur në rajon.²¹

4. Përfundimet

Në dekadat e fundit, përfshirja aktive e Komisionit Evropian, aktorëve rajonalë dhe organizatave ndërkombëtare, krahas angazhimit të vendeve të rajonit ka rezultuar pozitive për të arritur standartet e kërkuara në fushën e luftës kundër krimit të organizuar. Megjithatë, pavarësisht reformave dhe veprimeve të ndërmarra, Rruga Ballkanike mbetet një pikë e nxehtë (hotspot) lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, lëndëve narkotike dhe armëve.

Duke pranuar kompleksitetin e shkaqeve që lejuan zgjerimin e aktivitetit kriminal në rajon, del qartë teza se përgjigjet ndaj krimit të organizuar duhet të jenë të shumëfishta, të forta dhe të përfshijnë aktorë të ndryshëm. Nisur nga ndërlidhja e shtuar mes grupeve të krimit të organizuar, e cila tani arrin nivele globale, përgjigja e zyrtarëve ligjzbatues dhe politikëbërësve duhet po ashtu të kenë të njëjtën qasje. Nëse përpjekjet lokale dhe rajonale janë të nevojshme, në të vërtetë, “nevoja për një qasje të koordinuar në nivel evropian dhe ndërkombëtar është thelbësore”²²

Duke pasur parasysh natyrën transnacionale të krimit të organizuar në këtë rajon, organizimi dhe ndërmarrja e nismave rajonale për të luftuar krimin e organizuar paraqet një rëndësi kritike. Nëse, nga njëra anë, bashkëpunimi rajonal do të ndikojë në përmirësimin ekonomik, social, infrastrukturor, energjitik, drejtësi, çështjet e brendshme dhe bashkëpunimin e sigurisë nga ana tjetër, vlerësohet se, ende duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të zbatuar siç duhet efektivitetin rajonal strategjik.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni renditen ndër kërcënimet joushtarake me potencialin më të lartë të kërcënimit të sigurisë rajonale dhe lidhur me këtë shtetet ballkanike duhet të bashkëpunojnë në nivel rajonal për të përballuar me sukses këtë sfidë. Duke pasur parasysh historinë e kaluar të trazuar, duke përfshirë ndryshimet e vazhdueshme në kufij, ndikime të rëndësishme të jashtme dhe regjime të ndryshme politike, krijimi i një shoqërie të bashkuar, paqësore, të gatshme për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin bëhet e vështirë.

²¹ UNODC (2015), Regional Programme for South Eastern Europe (2016-2019). A Partnership Framework for an Effective Regional Approach, UNODC.

²² Balfour R. and Stratulat C, (2011), The Democratic Transformation of the Balkans, European Policy Centre Issue Paper, fq. 66

Për të trajtuar në mënyrë efektive kërcënimet që vijnë nga krimi i organizuar, “**ne duhet të bëhemi po aq të koordinuar, fleksibël dhe efektivë sa trafikantët**”.²³

Bibliografia

1. Balfour R. and Stratulat C, (2011), *The Democratic Transformation of the Balkans*, European Policy Centre Issue Paper,
2. Collins A. (2014). *Studime Bashkëkohore të Sigurisë* (Contemporary security studies). UET/PRESS, Tiranë,
3. Europol (2011), OCTA 2011. *EU Organised Crime Threat Assessment*, The Hague.
4. EU SOTCA (2021) Serious and Organised Crime Threat Assessment. *A corrupting influence: The infiltration and undermining of Europe's economy and society by organised crime*
5. The European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (EMCDDA) *European Drug Report 2023*
6. Greavu S. (eds.) (2016), *Annual Report of the Secretary General of the Regional Cooperation Council 2015-2016*, Sarajevo, RCC.
7. Krasniqi, K (2016). Organized Crime in the Balkans. *European Scientific Journal*, 12(19), 204-220
8. Lindstrom N. (2004), *Regional Sex Trafficking in the Balkans: Transnational Networks in an Enlarged Europe*, in “Problems of Post-Communism”, vol. 51, no. 3,
9. Lilyanova, V. (2017). Anti-corruption efforts in the Western Balkans. *EPRS | European Parliamentary Research Service*.
10. Nicolaj N. (2012), *Mexican drug cartels penetrate southern Europe*, euobserver
11. Projekti CARPO (2006) *Raporti mbi Gjendjen e Krimin të Organizuar dhe Krimin Ekonomik në Evropën Juglindore*. Strasburg.
12. Thomas, J. (2021). *Lufta kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor: forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e kimit të pasurive*. Këshillim për të Drejtat Individuale në Evropë (AIRE)& Nisma Rajonale Antikorrupsion (RAI).
13. The Global Initiative Against Transnational Organized Crime. (2019). *Zonat problematike të kimit të organizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor*. Geneva:
14. The Global Initiative against Organized Crime, *Analyzing flows of people, drugs and money in the Western Balkans*,
15. UNODC (2021). *Udhëzues i Strategjisë për Krimin e Organizuar për zhvillimin e strategjive me ndikim të lartë*.
16. UNODC, (2020) *Conceptual Framework for the Statistical Measurement of Illicit Financial Flows*,
17. UNODC (2015), Regional Programme for South Eastern Europe (2016-2019). *A Partnership Framework for an Effective Regional Approach*,
18. Wallis, E. (2020) *Migrants in Albania: Begging for food, hiding from violence*, Info Migrants.
19. Williams, P. *Transnational Criminal Networks, Networks and Netwars. The Future of Terror, Crime, and Militancy*, Santa Monica, CA, Rand Corporation.

²³ Lindstrom N. (2004), Regional Sex Trafficking in the Balkans: Transnational Networks in an Enlarged Europe, in «Problems of Post-Communism», vol. 51, no. 3, fq.46